

Vendim nr. 143 datë 24.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 21.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: DED GJINAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 52-2016-425 (107), datë 13.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë; nr. 773, datë 20.09.2018 të Gjykatës së Apelit Shkodër; nr. 00-2023-1952, datë 21.11.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 52, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka përfituar trajtim të veçantë si punonjës i minierave të nëntokës, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë” dhe është trajtuar me pension të veçantë si minator në masën 5.148 lekë në muaj. Këtë trajtim kërkuesi e ka përfituar duke filluar nga data 16.12.2000 deri në vitin 2015.

2. Me mbushjen e moshës për pension, kërkuesi ka aplikuar për të përfituar pension të plotë pleqërie, i cili është refuzuar, me arsyetimin se ai ka përfituar në mënyrë të padrejtë pensionin e parakohshëm dhe në vijim Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH), Shkodër i ka ndërprerë atij dhënien e pensionit.

3. Në datën 08.10.2015 kërkuesi ka paraqitur kërkesëpadi kundër DRSSH-së, Shkodër, me objekt “*Njohjen e vërtetësisë në favor të paditësit të periudhave të punës të kryera në llojin e punës punëtor nëntokë pranë: 1. Miniera e Bakrit Kurbnesh 02.11.1981-04.07.1989; 2. Miniera e Bakrit Perlat 22.07.1989-30.08.1993.*”.

4. DRSSH-ja, Shkodër nga ana e saj rezulton të ketë bërë kallëzimit penal, në bazë të të cilit është regjistruar procedimi penal nr. 25 i vitit 2016, në ngarkim të shtetasit Ded Gjinaj, akuzuar për veprën penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i Kodit Penal (KP).

5. Në vijim, DRSSH-ja, Shkodër i ka kërkuar gjykatës që po shqyrtonte çështjen civile pezullimin e gjykimit, pasi kishte paraqitur kallëzim penal ndaj paditësit, i cili ishte regjistruar nga prokuroria. Në këto kushte, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. “nuk ka”, datë 02.06.2016, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pezullimin e gjykimit të çështjes civile deri në zgjidhjen përfundimtare të hetimit dhe procedimit penal në ngarkim të kërkuesit.

6. Në gjykimin në shkallë të parë të çështjes penale, rezulton se kërkuesi nëpërmjet avokatit të tij, ka kërkuar vijimin e procesit gjyqësor në formën e gjykimit të shkurtuar, bazuar në nenin 405 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë, me vendimin nr. 52-2016-425 (107), datë 13.12.2016, ka vendosur ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së, në “Falsifikimi i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186, paragrafi i parë, i KP-së dhe pushimin e akuzës në ngarkim të të pandehurit Ded Gjinaj, për shkak të parashkrimit të veprës penale. Kundër vendimit ka ushtruar ankim organi i akuzës.

7. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 773, datë 20.09.2018, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi në sigurime”, të parashikuar nga neni 145 i KP-së, duke

e dënuar me 6 muaj burgim. Në bazë të nenit 59 të KP-së, ajo gjykatë ka urdhëruar pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të kërkuarit për 12 muaj. Kundër atij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuari.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-1952, datë 21.11.2023, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së.

9. Në datën 18.03.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Ankimi, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.04.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

10. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar:

10.1. *Të drejtën për proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të :

10.1.1. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykata e shkallës e parë e ka zhvilluar procesin gjyqësor me bindjen se kërkuari ka qenë fajtor. Për këtë arsye, ajo gjykatë nuk e ka shqyrtuar çështjen e tij në themel, por ka luajtur me termat për llojin e akuzës nëse ishte mashtrim ose falsifikim.

10.1.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi gjykatat kanë dhënë vendime të padrejta në rastin e tij, duke qenë se janë bazuar në prova të pasakta dhe jo të plota. Gjykatat nuk kanë marrë në konsideratë as provat dhe as pretendimet e kërkuarit, edhe pse ai ka pasur dëshmitarë dhe prova të mjaftueshme për të vërtetuar se ka punuar në minierën Perlat, por kanë vlerësuar me përparësi vetëm pretendimet e DRSSH-së, Shkodër. Kërkuari ka kundërshtuar me forcë kryerjen e veprave penale të mashtrimit ose falsifikimit të dokumenteve për arsye përfitimi të pensionit nëpërmjet ndërhyrjes në regjistrat e arkivave, pasi ai nuk ka pasur mundësi efektive të ndërhynte në regjistra. Për pasojë, ai ka mbajtur përgjegjësi penale për personat e papërgjegjshëm që kanë administruar arkivat.

10.2. *Të drejtën për pension*, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykatat e të tria shkallëve të gjykimin, në vendimmarrjen e tyre nuk kanë marrë parasysh faktin se kërkuesi është një person i moshuar, pa asnjë të ardhur tjetër përveç pensionit. Në këtë mënyrë është cenuar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë edhe e drejta e jetës, pasi kërkuesi është lënë në pozita të vështira jetese.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimin kushtetues.

12. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Kriteri i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, kërkon që individi t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë cenuar. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individi t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih*

vendimet nr. 24, datë 27.04.2023; nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese).

14. Në rastin konkret, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të parimit të prezumimit të pafajësisë, vërehet se kërkuesi nuk rezulton të ketë bërë më parë përpjekje në asnjë nga mjetet juridike të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për të ngritur këtë pretendim, por e ka parashtruar për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, vlerësohet se kërkuesi nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

15. Për sa i përket pretendimit që ka të bëjë me cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, konstatohet se në lidhje me vendimin e gjykatës se apelit që e ka deklaruar fajtor, kërkuesi e ka ngritur këtë pretendim të paktën në substancë në rekurs. Ndërsa, lidhur me vendimin e Gjykatës së Lartë ai nuk ka më mjete në dispozicion për kundërshtimin e tij përveç ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë vlerësohet se i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion për këtë pretendim.

16. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar mban datën 21.11.2023, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 18.03.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

17. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar e drejta për pension pleqërie. Kolegji vëren se vendimet të cilat janë kundërshtuar nga kërkuesi, e kanë deklaruar atë fajtor për veprën penale “Mashtrimi në sigurime”, të kryer nëpërmjet falsifikimit të dokumentacionit, me qëllim për të përfituar padrejtësisht trajtim të veçantë si minator i nëntokës, por ato nuk kanë rregulluar në mënyrë specifike të drejtën për pension pleqërie. Në këtë situatë, Kolegji çmon se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi nuk lidhet drejtpërdrejt me skemat e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar të pleqërisë, për rrjedhojë ai nuk e përmbush kriterin e legjitimit *ratione materiae*.

18. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, që *prima facie* hyn në juridiksionin kushtetues, ndaj, në vijim, do të analizohet bazueshmëria e tij në themel.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit

19. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat në deklarin e tij fajtor nuk kanë marrë në konsideratë provat dhe pretendimet e tij edhe pse ai ka pasur dëshmitarë dhe prova të mjaftueshme, por kanë vlerësuar me përparësi pretendimet e kallëzuesit. Ato gjykata kanë dhënë vendime të padrejta në rastin e tij duke u bazuar në prova të pasakta dhe të paplota, ndër to mbi 12 raporte barrë lindjesh. Kërkuesi ka kundërshtuar me forcë kryerjen e veprave penale në ngarkim të tij, duke argumentuar se ai nuk ka pasur mundësi efektive të ndërhynte në regjistrat e arkivave, për pasojë ka mbajtur përgjegjësi penale për persona të tjerë.

20. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Gjykata ka pohuar se vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, si dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërrënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimin nr. 23, datë 29.04.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Zbatimi i standardit të arsytimit të vendimit është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 71, datë 30.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsytimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadër të përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka pranuar se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por

ndërhyn atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 34, datë 12.06.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Lidhur me procedurën e gjykimit të shkurtuar, Gjykata ka mbajtur qëndrimin se gjykimi i shkurtuar është një gjykim i posaçëm, i cili konsiston në heqjen dorë në mënyrë të vullnetshme dhe eksplicite nga ana e të pandehurit nga disa aspekte themelore të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të tilla, si, parimi i barazisë së armëve dhe ai i formimit të provës në kontradiktoritet, në këmbim të një sërë avantazheve që atij i garantohen nga legjislacioni i brendshëm, pra për të përfituar një ulje të dënimit (*shih vendimin nr. 4, datë 10.02.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara konstatohet se gjatë gjykimit në shkallë të parë, në fazën e kërkesave paraprake, avokati mbrojtës i kërkuarit, në bazë të neneve 334, 354 dhe 403 të KPP-së, sipas përmbajtjes së tyre në kohën e shqyrtimit të çështjes, i ka kërkuar gjykatës në seancë gjyqësore gjykimin e çështjes në formën e gjykimit të shkurtuar. Në këtë mënyrë ai i ka pranuar të gjitha provat dhe aktet në gjendjen që ishin paraqitur nga organi i akuzës, rrjedhimisht ka hequr dorë në mënyrë të vullnetshme edhe nga disa të drejta gjatë procesit penal, si më sipër. Ajo gjykatë, pasi ka dëgjuar mendimin e organit të akuzës, që ka qenë dakord me kërkesën, ka vlerësuar se çështja mund të zgjidhej drejt dhe objektivisht në gjendjen që ishin aktet, ndaj ka vendosur pranimin e kërkesës (*shih faqen 2 të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë*). Nuk rezulton që kërkuari të ketë kërkuar revokimin e vendimit për gjykimin e shkurtuar dhe shqyrtimin e çështjes sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm. Po kështu, nuk rezulton që kërkuari të ketë qenë në pamundësi për të kërkuar që çështja e tij të shqyrtohej me gjykim të zakonshëm, në mënyrë që t'ia nënshtrohte provat debatit gjyqësor në vështrim të parimit të kontradiktoritetit. Për sa kohë që ai, në mënyrë të vullnetshme, ka hequr dorë nga procesi i formimit dhe debatimit të provave në gjykim, nuk mund t'i ngrejë këto pretendime në gjykimin kushtetues individual.

24. Për më tepër, Kolegji vëren se kërkuari ka pretenduar se është gjykuar dhe dënuar në bazë të disa dokumenteve të pasakta, ndër to mbi 12 raporte barrë lindjesh, por vërehet se asnjë nga gjykata e juridiksionit të zakonshëm nuk shprehet në vendim për një provë të tillë, dhe as kërkuari nuk rezulton që të ketë pretenduar më parë në mjetet ankimore të parashikuara nga legjislacioni në fuqi lidhur me këtë.

25. Në vijim të analizës së mësipërme, Kolegji vëren se gjykata e apelit, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e prokurorit, ka arritur në përfundimin se kërkuari ishte fajtor për kryerjen

e veprës penale “Mashtrimi në sigurime” dhe e ka dënuar atë me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të KP-së ka vendosur pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënien në provë të tij për 12 muaj.

26. Kolegji konstaton se në thelb kërkuesi nuk pajtohet me vendimet e gjykatave, si rezultat i të cilave ai është deklaruar fajtor dhe çmon se pretendimet e tij nuk kanë të bëjnë me cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por me vlerësimin e provave dhe interpretimin e ligjit, të cilat hyjnë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme dhe jo të atij kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se gjykata e apelit e ka respektuar standardin e arsytimit të vendimit.

27. Lidhur me vendimin e Gjykatës së Lartë, Kolegji konstaton se ajo gjykatë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me argumentin se nuk përmbante asnjë nga shkaqet që parashikohen në nenin 432 të KPP-së. Ndër të tjera, është arsyetuar se pretendimet e ngritura në rekurs ngrenë çështje të vlerësimit të faktit dhe të provave, të cilat dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 13 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Po kështu, ajo gjykatë ka konstatuar se gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në vendimet e tyre dhe ka mbajtur qëndrimin se vendimmarrja e gjykatës se apelit lidhur me cilësimin juridik të faktit penal dhe fajësinë e kërkuesit ishte në përputhje me ligjin material penal. Sipas saj, vepra penale e falsifikimit të dokumenteve ishte kryer nga kërkuesi në funksion të mashtimit të organeve të sigurimeve shoqërore për përfitim të padrejtë të trajtimit të veçantë të minatorit dhe se gjykata e apelit ka konkluduar drejt - referuar aktit të ekspertimit - se data e largimit nga puna në Minierën e Bakrit Kurbnesh rezultonte me korrigjime dhe se kjo periudhë pune dublohet tërësisht me periudhën e punës në Parkun e Automallrave Pukë (*shih paragrafët 16 - 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

28. Nga sa më lart, Kolegji konstaton se vendimi i Gjykatës së Lartë në pjesën hyrëse përmban palët, bazën ligjore, rrethanat e çështjes, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, si dhe qëndrimin e saj lidhur me këto vendimmarrje, si dhe pretendimet e ngritura në rekurs. Vendimi nuk rezulton të jetë kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm, me kundërthënie ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga dispozitat ligjore dhe standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë e ka respektuar standardin e arsytimit të vendimit.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.